

së largu, dhe nukë deshte të ngrente as sytë në qjell, po e goditte krahërorin, edhe thoshte: “O Perëndi, kij mëshirë për mua mëkatarin.” Ja ku ju thom se ky zbriti në shtëpinë e vetë më i drejtësuar se ay. Se cilido, që e lartëson veten, do të përunjët, po ay, që e përunjët veten, do të lartësohet.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.

E DIELA E BIRIT PRODIK

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe dy të Triodit, dyke përsëritur të parën:

T. I. Mbolla mëkatin në arën e gjallë që më ke dhënë; kora me drapër kallinjte e ngathësisë; i togësova me duaj qypitë e veprave, dhe nuk i shtrova në lëmin e pendimit. Po të lutem o Perëndi, o bujk i përjetmë, përnda-ma kashtën e veprave me erën e mëshirës, nem në shpirtin grurin e ndjesës, vëndos-më në hambarin qjellor dhe shpëto-më.

Le ta kupëtojmë o vëllezër, forcën e misterit: Se Ati zëmërmirë dolli, dhe e priti Birin Prodik, që u-kthye nga mëkati në vatrën atërore, ia dhuroj përsëri shenjat e lavdisë prindërore, dhe ia sakrifikoj viçin e ushqyer, që kështu edhe ne të sillemi, ashtu sikundër na ka hie, përpara Atit njeridashës, edhe viktimës së lavdëruar, Shpëtimtarit të shpirteve.

LAVDI, T. II. Oh sa të mira kam humbur un i mjeri! Oh nga cila mbretëri jam dbuar un i ziu! E prisha pasurinë që trashëgova, dhe e shkela porrosinë.

Mjerë ti o shpirt i mjerë! Se po dënohesh për zjarrin e përjetmë. Pra thirr-i Krishtit përpara fundit: Prit-më si Birin Prodik, o Perëndi dhe mëshiro-më.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T. T. II. E përndava pasurinë e dhuratës atërore, kullota me bagëtitë un i mjeri, dhe vdiqa nga uria, se nukë nginjësja dot nga ushqimi i tyre. Po u-këtheva pranë Atit mëshirëplot, edhe i thërres i përlotur: : Prit-më si rogetar të përunjur, dhe shpëto-më o njeridashës.

Tania e Tingëllit, edhe Përlëshoret e Tingëllit.

SHKURTORJA, T. III PAS I PARTHENOS SIMERON

Nga pallati atëror, me marrësi u-largova, e përndava rugëve, çdo pasuri që më fale, pra thërres, posi Prodigu, sot i përlotur: Bëra faj, përpara teje At i mëshirës, të penduar prit-m' e fal-më, dhe merr-më vetëm, me rogë si shërbëtor.

SHTEPIA

Le ta dëgjojmë Shpëtimtarin, kur na jep mësimë vetë për ditë, me anën e Shkripturave, dhe le ta imitojmë me besë Prodigun, që e mblodhi mëndjen dhe u-pendua, dhe të le thërresim me zëmër të përunjur: Mëkatuam o Atë mëshirëplot, edhe nukë meritojmë të quhemi bij të tu si më parë. Po prit-më si njeridashës, dhe merr-më vetëm, me rogë si shërbëtor.

SINAKSARI

Gjithë sot, kujtojmë parabollën e Birit Prodik prej Ungjillit të Shën Llukajt, të cilën Atërit tanë të Shënjtë e caktuan për të Dielën e dytë të Triodit.

Me njeridashjen tënde të patreguar, o Krisht, o Perëndi, mëshiro-na dhe shpëto-na. Amin.

ZBRITESORET, T. II.
TIS MOSEOS ODIN

I. Nis o shpirt e këndo, si Moisiu thirr e lavdëro. Ti më ndih ti më përkrah, ti më shpëto nga të gjith' armiqtë, ti je Zoti im, edhe ty të këndonj.

III. Mëndjen time që m' u-tha, bëj-e ti o Perëndi, të sjellë pemë, ti që mbiell ti që kor, çdo të mirë përmi dhe, Zot i mëshirave.

IV. Lindjen tënde të çudiçime, e parëpa Profeti, edhe tha me zë të math: Ta dëgjova namin dhe jam trëmbur, se prej Thajmanit edhe malit hieplotë, na ke ardhur ti o Krisht.

V. Ja ku shkoj errësira, ja ku ardhni dita, edhe drita ndriti kudo mi dhe, përandaj pra me këngë, Engjëjtë prej qjellit, të lavdërojnë o Krisht Perëndi.

VI. I mbytur në mëkata, po dergjem Shpëtimtar, vuanj në detin e jetës së shqotave; eja pra dhe si Profetin Shën Jona, nga pellgu i pasioneve, nxir-më dhe shpëto-më.

VII. Zoti në Sina, i tregoj Moisiut, lindjen e Virgjërshës, me çudin' e ferrës pra të gjithë, e bekoni dhe e lartësoni, për herë dhe për jetë.

IX. Cili ka dëgjuar gjë t' atillë, dhe kush ka parë përmi dhe, një Virgjërshë të pangarë, si Nënë për çudi, edhe një foshnjë të lindë pa dhëmbje fare? Pra ty Mari të lavdërojmë, si Zonjë dhe Hyjlindëse.

Pas Dërgimësore Ngjallësore këndohen:

DERGIMESORET, T.II.
PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Çdo pasuri edhe çdo hir, që ti më ke dhuruar, e çkatërrova n' arrati, keq e më keq i mjeri, dhe me demonët jetova, si një prodik i prapë, tani pra kthehem përsëri, i penduar me lote dhe psherëtim, dhe të lutem Atë fal-më dhe merr-më, o Perëndi si rogetar, o Zot o njeridashës.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na përsërite shpirtin, të prishur prej mekata-ve, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen pesë të Tingëllit edhe tri të Triodit:

T. II. Lutjen e Prodigut të blatonj o Zot: Përpara teje fëjeva, e prisha thesarin e dhuratave, po prit-më të penduar, o Shpëtimtar dhe shpëto-më.

Si Prodigu po të vinj, o Zot i zëmërdhëmpshur; e çkatërrova pasurinë që më dhurove, po prit-më të penduar, o Perëndi dhe mëshiro-më.

T. T. IV. E harxhova prodigërisht, pasurinë atërore, dhe u-arratisa në mërgim, midis të paudhëve dhe të pabesëve. U-këtheva pra dhe të thërres o Atë: Fëjeva përpara qiellit, edhe përpara teje, dhe nukë meritonj të quhem yt-bir, merr-më si një rogetar, o Perëndi dhe mëshiro-më.

LAVDI, T. T. II. O At i mirë, u-largova prej teje, mos më neverit, mos më quaj të pavyer, për mbretërinë tënde. Armiku i paudhë më çveshi, dhe ma vodhi pasurinë. I çkatërrova dhuratat e shpirtit prodigërisht; u-ngrita pra dhe u-këtheva dhe të thërres: Merr-më si një rogetar, ti që u-kryqësove për mua, dhe rëmbe-më prej egërsirës së tmerruar, dhe vesh-më me stolinë e parë, si i vetëmi mëshirëplot.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjeshë.

Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Tingëllit, e Shenjtit të Kishës, pastaj:

SHKURTORJA, T. III

PAS I PARTHENOS SIMERON

Nga pallati atëror, me marrësi u-largova.

APOSTULLI

Arthtë mëshira jote mi ne, o Zot.

Ngazëllohuni më Zotin, o të drejtë.

Këndimi prej Letrës I së Palit për Korinthianët.

Vëllezër, të gjitha më përmetohen, po nukë më japin dorë të gjitha. Të gjitha më përmetohen, po asnjë gjë nukë do më zotëronjë. Të ngrënat janë për barkun, dhe barku për të ngrënat; po Perëndia do ta abolitë edhe këtë edhe ato. Edhe trupi nuk është për lavirësinë po për Zotin, edhe Zoti është për trupin. Edhe Perëndia e ngriti edhe Zotin, edhe do na ngrerë me forcën e vetë edhe ne. A nuk e dini që trupet tuaja janë mise të Krishtit? Vallë a duhet t'i bënj miset e Krishtit mise të lavirës? Perëndia mos e dhëntë. Apo nuk e dini se ay, që ngjitet pas një lavire, bëhet një

trup me atë? Se Zoti tha që do të jenë një trup që të dy. Po ay, që ngjitet më Zotin, bëhet një shpirt me atë. Largohuni nga lavirësia. Çdo mëkat, që bën njeriu, është jashtë trupit; po ay, që lavirëson, mëkaton përbërënda trupit. Apo nuk e dini që trupi juaj është tempulli i Shpirtit të Shenjtë, të cilin e keni nga Perëndia, dhe nukë jini zotër të vetes suaj, po të blerë me një çmim prej Perëndisë? Pra, lavdëroni Perëndinë me trupin tuaj dhe me shpirtin tuaj, të cilat janë të Perëndisë.

UNGGJILLI PAS LLUKAJT

Zoti tha këtë parabolë: Një njeri kishte dy bij. Edhe më i vogëli prej këtyre i that t' atit: "Nëma pjesën e gjësë, që më bie." Dhe ay ua ndau gjënë. Edhe pas pakë ditësh biri më i vogël i mbloodhi të gjitha, dhe u-mërgua në një vënt të larkmë, dhe atje e përndau gjënë e vetë, dyke jetuar prodigërisht. Edhe passi i harxhoj të gjitha, u-bë një zi e fortë n' atë vënt, edhe ky nisi të shterohej. Edhe shkoj, edhe u-ngjit pas një qytetari të ati vëndi, dhe ay e dërgoj nër arat e veta për të kullotur derrat. Edhe përpiquej ta mbushte barkun me brinjët, që hanin derrat, po askush nuk i jipte. Dhe ardhi më veten, edhe tha: "Sa rogetarëve të tim-ati u tepërojnë bukët, kur unë këtu po vdes urie. Pra, do të ngrihem, edhe do të vete tek im-atë, dhe do t'i thom: "Atë, fëjeva përpara qjellit edhe përpara teje, dhe nukë jam i vyer më të quhem yt-bir; merr-më si një rogetar." Edhe u-ngrit, edhe vajti tek i-ati. Dhe i-ati e pa për së largu, dhe i ardhi keq, edhe rendi, dhe e puthi. Dhe i-biri i tha: "Atë, fëjeva përpara qjellit edhe përpara teje, dhe nukë jam i vyer të quhem yt-bir.." Edhe i-ati u tha shërbëtorëve: "Sillini stolinë e parë, dhe visheni,

dhe jepini unazën në dorë, dhe këpuce për këmbët, edhe bjereni viçin e ushqyer, edhe thereni, që të hamë dhe të dëfrenjmë, se im-bir ish i vdekur dhe u-ngjall, ish i humbur dhe u-gjent.” Edhe nisë të dëfrenin. Dhe i-biri i math ishte në arën. Dhe kur po kethehej dhe afrohej në shtëpi, dëgjoj muzika dhe valle, dhe thirri një shërbëtor dhe e pyeti seç qenë gjithë ato. Edhe ay u-përgjiej: “Yt-vëlla ka ardhur, dhe yt-atë ka therur viçin e ushqyer, se e pa të shëndoshë.” Dhe ay u-zëmërua, dhe nukë deshte të hynte brënda. I-ati, pra, dolli dhe i lutej. Po ay u-përgjiej edhe i tha t’ atit: “Ja ku po punoj kaqë vjetë për ty, edhe kurrë nukë kam shkelur porrositë e tua, dhe nukë më ke dhënë kurrë nonjë kec, që të dëfrenj me miqtë e mi; po kur ardh i yt-bir, i cili ta ka ngrënë gjënë me lavirat, ia there viçin e ushqyer.” Dhe ay i tha: “Bir, ti je gjithënjë me mua, dhe të gjitha të miat janë të tuat. Po duhej të dëfrenja dhe të gëzohësja, se yt-vëlla ish i vdekur dhe u-ngjall, ish i humbur dhe u-gjent.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.

E SHTUNA E SHPIRTEVE

Për këndimet shiko të Shtunën përpara Rushajeve.

E DIELA E TE LIDHURAVE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë Tropare, domethënë shtatë të Tingëllit edhe dy të Përshëmbëllta të Triodit më T.T.II, dyke përsëritur të parën: